



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ
DREJTORIA E TË ARDHURAVE

Nr. 3659 Prot.

Maliq, më 18.7.2023

Lënda: Njoftim për shpallje

SEKTORIT TË TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
Maliq

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 64, gërma (a), në ligjin nr. 8308, datë 18.03.1998, "Për transportet rrugore", i ndryshuar, neni 15 pika, neni 19; Udhëzimin nr. 5627, dt. 18.11.2016, e Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, “Për përcaktimin e kritereve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e liçencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit”, të ndryshuar, neni 11 dhe Urdhrit të Kryetarit Nr. 370, datë 18.07.2023, po ju dërgojmë njoftimin për shpallje për “Përzgjedhjen e operatorit/operatorëve në linjat rrethqytetëse të transportit të udhëtarëve të Bashkisë Maliq”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

KRYETARI I BASHKISË
GËZIM TOPÇIU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALIQ
DREJTORIA E TË ARDHURAVE**

SHPALLJA E KONKURSIT PËR LINJAT RRETHQYTETËSE

1- Të hapet konkursi për përzgjedhjen e operatorit/operatorëve në linja rrethqytetëse të transportit të udhëtarëve si më poshtë :

Nr.	Linja rrethqytetëse	Numri i orareve të shërbimeve në linjë
1	Velitërnë-Korçë-Kthim	Nisja: 07:30, 10:00, 12:30 Kthimi: 08:45, 11:30, 14:30
2	Shqitas-Korçë-Kthim	Nisja: 07:30, 10:30, 12:30 Kthimi: 10:00, 12:00, 14:00
3	Leminot-Korçë-Kthim	Nisja: 07:30, 10:30, 12:30 Kthimi: 10:00, 12:00, 14:00

2- Komisioni i ngritur për përzgjedhjen e operatorit do të shqyrtojë dokumentacionin e paraqitur në përputhje me kërkesat e udhëzimit nr. 5627, datë 18.11.2016, të ndryshuar, si më poshtë:

- a. Kërkesa;
- b. Formulari i autodeklarimit (për drejtuesin / drejtuesit e veprimtarisë);
- c. Vërtetimi nga Gjykata (për drejtuesin / drejtuesit e veprimtarisë);
- d. Vërtetimi nga Prokuroria (për drejtuesin / drejtuesit e veprimtarisë);
- e. Dokumentacioni i kredibilitetit bankar;
- f. Certifikata e kompetencës profesionale në transportin rrugor (në rast se subjekti disponon më shumë së një mjet);
- g. Certifikata e regjistrimit dhe ekstrakti i regjistrimit tregëtar për të dhënat e subjektit nga Q.K.B. (me seli në territorin e Bashkisë Maliq);
- h. Leja e qarkullimit (për çdo autobus);
- i. Certifikata e kontrollit teknik (për çdo autobus);
- j. Akt-vlerësimi në plotësimin e kushteve të komoditetit në transportin e udhëtarëve

(për çdo autobus);

- k. Certifikata e kalibrimit të tahografit (për çdo autobus);
- l. Kontrata për sigurimin e automjetit (për çdo autobus);
- m. Kontrata për sigurimin e pasagjerëve (për çdo autobus);
- n. Leja e drejtimit;
- o. Certifikata e Aftësisimit Profesional (CAP);
- p. Kontrata e punësimit (në rast se drejtuesi i mjetit nuk është pronar i tij);
- q. Kontrata me agjencinë për transport udhëtarësh brenda vendit;
- r. Vërtetim nga Drejtoria e të Ardhurave të Bashkisë Maliq, mbi kryerjen e pagesës të taksave dhe tarifave vendore (për subjektet që kanë ushtruar aktivitet në periudhën e mëparshme);

- *Dokumentacioni dorëzohet në origjinal ose fotokopje e noterizuar.*

3- Komisioni pranon dokumentacionin e paraqitur pranë Bashkisë Maliq, deri në datën 02.08.2023.